

I FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

DILAPRO

Tableta – 12.5 mg

Tableta – 25 mg

(Karvedilol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efektëve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Dilapro dhe përse përdoret?
2. Përpara se të merrni Dilapro
3. Si ta merrni Dilapro?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Dilapro?
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË DILAPRO DHE PËRSE PËRDORET?

Dilapro përmban lëndën vepruese karvedilol, i cili shkakton bllokadë joselektive të receptorëve beta-1 dhe beta-2 si dhe bllokadë selektive të receptorëve alfa-1 në zemër dhe në sistemin vaskular.

Dilapro përdoret për:

- trajtimin e presionit të lartë esencial të gjakut
- trajtimin e angina pectoris kronike dhe të stabilizuar
- trajtimin suplementar të insuficiencës kardiake kronike, të stabilizuar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI DILAPRO

Dilapro nuk duhet të merret në:

- mbindjeshmëri (alergji) ndaj karvedilolit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të Dilapro;
- shok kardiojen;
- insuficiencë kardiake që është në përkeqësım (insuficiencë kardiake e dekompensuar)
- emboli pulmonare akute;
- anginë Prinzmetal;
- hipotension të theksuar (presioni sistolik më i ulët se 90 mm Hg);
- rrahje shumë të ngadalta të zemrës (pacientët, të cilët trajtohen me Dilapro për insuficiencën kardiake, duhet të kenë në qetësi një frekuencë të rrahjeve të zemrës prej të paktën 65 rrahje / minutë);
- çrregullime të caktuara të përcusshmërisë në zemër: bllok AV i shkallës së II ose të III, sindrom i sinusit të sëmurë, bllok sinoatrial (përshtim: terapia pace-maker);
- insuficiencë kardiakë që ka ardhur si pasojë e sëmundjes së rrugëve të frymëmarjes cor pulmonar);
- astmë ose sëmundje të tjera të rrugëve të frymëmarjes me tendencë për ngushtım spazmodik të tyre (p.sh. sëmundje pulmonare obstruktive kronike)
- feokromocitomë të patrajtuar (tumor i palcës së gjendrave mbiveshkore);
- çrregullime të rënda të funksionit të mëlcisë;
- acidifikim të gjakut (acidozë metabolike);
- rast se njëkohësisht trajtoheni me frenues të MAO-s (përveç frenuesve të MAO-B);
- trajtimin e njëkohshëm intravenoz me verapamil, diltiazem ose barna të tjera antiaritmike;
- periudhën e ushqyerjes me gj.

Tregoni kujdes të veçantë me Dilapro

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Dilapro:

- në qoftë se keni insuficiencë kardiakë të shoqëruar nga:
 - presion i ulët i gjakut;
 - furnizim i ulët me gjak dhe oksigjen i zemrës (sëmundja ishemike e zemrës) dhe ngushtimi i arterieve (arterioskleroza);
 - dhe / ose problemet e veshkave (në këtë rast duhet të monitorohet funksioni juaj i veshkave dhe mund të jetë i nevojshëm reduktimi i dozës);
- në qoftë se keni mosfunksionim të ventrikullit të majtë pas një infarkti akut të miokardit;
- në qoftë se keni diabet; trajtimi me Dilapro mund të maskojë shenjat e sheqerit të ulët në gjak, prandaj sheqeri juaj në gjak duhet të monitorohet rregullisht;
- në qoftë se keni probleme të rëndësishme të frymëmarjes për të cilat nuk po merrni mjekim; Dilapro mund t'i keqësojë këto probleme të frymëmarjes;
- në qoftë se përdorni lente kontakti; karvediloli mund të reduktojë prodhimin e lotëve;
- në qoftë se keni fenomenin Raynaud (gishtat në fillim marrin një nuancë blu, më pas të bardhë dhe më vonë skuqen dhe dhembin), ose ndonjë sëmundje tjetër vaskulare periferike; Dilapro mund të keqësojë simptomat;
- në qoftë se keni mbifunksionim të gjendrës tiroide, me prodhim të shtuar të hormonit tiroid; Dilapro mund të maskojë simptomat;
- në qoftë se jeni duke përdorur Dilapro dhe do t'i nënshtroheni një operacioni ku përdoret anesteziç; duhet të diskutoni mirë më përpara për këtë me mjekun përgjegjës për anesteziçin;
- në qoftë se keni puls të ulët (më pak se 55 rrahje në minutë);
- në qoftë se keni patur një reaksion serioz alergjik (p.sh. nga një pickim insekti ose nga një ushqim) ose në qoftë se i jeni nënshtruar ose do t'i nënshtroheni një terapie për heqjen e ndjeshmërisë me natyrë alergjike, sepse Dilapro mund të dobësojë efikasitetin e barnave të përdorura për trajtimin e reaksioneve të tilla alergjike;
- në qoftë se keni psoriazë;
- në fëmijë dhe adoleshentë (nën 18 vjeç), sepse nuk ka të dhëna të mjaftueshme mbi efikasitetin dhe dëmet që ai mund të shkaktojë; nuk rekomandohet përdorimi i karvedilolit në këtë grupmoshë pacientësh;
- në personat e moshuar, sepse mund të jenë më të ndjeshëm ndaj karvedilolit dhe duhen monitoruar me kujdes. Ashtu si edhe beta-blokuesit e tjerë, sidomos tek pacientët me çrregullime të qarkullimit të enëve koronare, karvediloli nuk duhet ndërprerë në mënyrë të menjëhershme, por graduale.

Efektet e keqpërdorimit për qëllime dopingu

Përdorimi i Dilapro mund të çojë në rezultate pozitive gjatë kontrollit për doping. Pasojat në shëndet nga ky lloj përdorimi nuk mund të parashikohen. Nuk mund të përjashtohen rreziqe të rëndë për shëndetin.

Marrja e barnave të tjera

Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Dilapro. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohet e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Dilapro në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- digoksin (për trajtimin e insuficiencës kardiake);
- rifampicin (antibiotik i përdorur për trajtimin e tuberkulozit);
- cimetidin (bar për trajtimin e ulçerës së stomakut, aciditetit në stomak dhe refluxit acid);
- ketokonazol (bar për trajtimin e mykozave);
- fluoksetin (bar për trajtimin e depresionit);
- haloperidol (bar për trajtimin e psikozave të veçanta mendore / psiqike);
- eritromicin (antibiotik);
- ciklosporinë (bar për suprimimin e sistemit imun, për parandalimin e reaksioneve të mospranimit pas transplantit të organeve, gjithashtu i përdorur p.sh. për probleme të caktuara reumatike ose dermatologjike);
- klonidinë (bar për reduktimin e presionit të gjakut ose trajtimin e migrenës);

- verapamil, diltiazem, amiodaron (barna për trajtimin e aritmive);
- kinidinë, disopiramid, meksiletin, propafenon, flekanid (barna për trajtimin e aritmive);
- barna të tjera për uljen e presionit të gjakut; karvediloli mund të shtojë efektin e barnave të tjera të përdorura për uljen e presionit të gjakut të dhëna njëkohësisht (p.sh. antagonistët e receptorëve alfa-1) dhe barnave që uljen e presionit të gjakut e japin si efekt anësor, p.sh. barbituratet (në trajtimin e epilepsisë), fenotiazinat (për trajtimin e psikozave), antidepressivët tricyclikë (në trajtimin e depresionit), barnat vazodilatatorë (barnat për zgjerimin e enëve të gjakut) dhe alkooli;
- insulinë ose antidiabetikë oralë (agjentë për uljen e sheqerit në gjak), meqenëse efekti i tyre për uljen e sheqerit në gjak mund të shtohet dhe të maskohen simptomat e sheqerit të ulët në gjak;
- anesteziçë (barnat e përdorura në anesteziç);
- simpatomimetikë (barna që shtojnë funksionin e sistemit nervor simpatik);
- dhidropiridina (barna për trajtimin e presionit të lartë të gjakut dhe sëmundjeve të zemrës);
- nitrate (barna për trajtimin e sëmundjeve të zemrës);
- preparate bilokues neuromuskulare (barna të cilat reduktojnë tensionin muskular);
- ergotaminë (bar për trajtimin e migrenës);
- disa tableta kundër dhimbjes (AJS), estrogenë (hormone) dhe kortikosteroidë (hormone adrenale), meqenëse këto në disa rrethana ulin efektin e karvedilolit;
- barna që përbajnë rezepinë, guanetidinë, metildopa, guanfacinë dhe frenues të monaminooksidazës (FMAO) për trajtimin e depresionit, meqenëse këto mund të çojnë në një ulje të mëtejshme të rrahjeve të zemrës.

Marrja e Dilapro me ushqim dhe pije

Dilapro mund të forcojë efektin e alkoolit.

Shtatzënia dhe ushqimi me gj

Nëse jeni shtatzënë apo ushqeni me gj, nëse dëshoni se jeni shtatzënë apo planifikoni një shtatzëni, kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit përpara se të përdorni këtë bar.

Ekziston rreziku i dëmtimit të fëmijës së palindur. Mund të përdoret gjatë shtatzënisë vetëm në qoftë se mjeku e sheh të nevojshme (në rastet kur nevoja për trajtim tejkalon rreziqet e mundshme për fetusin / foshnjën e porsalindur). Prandaj, gjithmonë konsultohuni me mjekun tuaj përpara se të përdorni Dilapro gjatë shtatzënisë. Karvediloli kaal në qumështin e gjirit dhe prandaj nuk duhet të përdoret gjatë ushqimit të foshnjës me gj.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Trajtimi me këtë bar kërkon kontrollin të rregullta mjekësore.

Në fillim të trajtimit, kur rritet doza ose kur ndryshohet preparati si dhe gjatë ndërveprimit me alkoolin, mund të keni marramendje dhe lodhje. Në qoftë se ju merren mendtë ose ndiheni i dobët gjatë marrjes së tabletave, duhet të evitoni drejtimin e automjetit ose punën që kërkon vëmendje të lartë.

3. SI TA MERRNI DILAPRO?

Gjithmonë merreni Dilapro sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Dilapro janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Tabletat duhet të gëlliten me të paktën gjysmë gote ujë. Rekomandohet që Dilapro të merret bashkë me ushqimin në mënyrë që lënda vepruese të merret më ngadalë dhe në këtë mënyrë të minimizohet mundësia e shqetësimeve të qarkullimit të gjakut nëse ngriheni në mënyrë të menjëhershme (efekti ortostatik). Kohëzgjatja e trajtimit përcaktohet nga mjeku. Zakonisht, trajtimi me karvedilol zgjat në kohë dhe duhet që ai mos të ndërpritet në mënyrë të menjëhershme, por gradualisht për 1 – 2 javë.

Për përdorim vetëm tek të rriturit:

Nëse nuk përshkruhet ndryshe nga mjeku, doza e zakonshme është:

Insuficiencë kardiakë kronike e stabilizuar	Doza ditore
	14 ditët e para:
Doza fillestare	3.125 mg karvedilol në mëngjes dhe 3.125 mg karvedilol në darkë
	Nëse kjo dozë tolerohet, ajo rritet në intervale prej të paktën 2 javësh në: 6.25 mg karvedilol në mëngjes dhe 6.25 mg karvedilol në darkë, më pas
Doza normale	12.5 mg karvedilol në mëngjes dhe 12.5 mg karvedilol në darkë, më pas 25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë. Do të merret doza maksimale c toleruar nga pacienti.
Doza maksimale në raste të veçanta	25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë.

Vetëm tek pacientët me pamjaftueshmëri kronike të funksionit të zemrës (insuficiencë kardiakë kronike), të stabilizuar, të lehtë ose të moderuar, me peshë trupore mbi 85 kg, doza maksimale ditore mund të rritet në 50 mg karvedilol dy herë në ditë, por kjo duke e mbajtur pacientin nën mbikqyrje dhe kujdes intensiv.

Presion i lartë esencial i gjakut	Doza ditore
	Në 2 ditët e para: 12.5 mg karvedilol një herë në mëngjes.
Doza fillestare	25 mg karvedilol një herë në ditë në mëngjes
Doza normale	25 mg karvedilol një herë në ditë në mëngjes
	Minimumi pas 14 ditësh: 25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë.
Doza maksimale në raste të veçanta	

Kujdes! Doza unike prej 25 mg ose doza ditore prej 50 mg karvedilol nuk duhet tejkaluar.

Angina pectoris kronike, e stabilizuar	Doza Ditore
	Në 2 ditët e para: 12.5 mg karvedilol në mëngjes dhe 12.5 mg karvedilol në darkë
Doza fillestare	25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë
Doza normale	25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë
	Minimumi pas 14 ditësh: 50 mg karvedilol në mëngjes dhe 50 mg karvedilol në darkë.

Dozimi tek të moshuarit:

Në presion të lartë esencial të gjakut

Doza fillestare	Në 2 ditët e para: 12.5 mg karvedilol në mëngjes
Doza normale	Nëse efekti nuk është i mjaftueshëm, doza mund të rritet në intervale prej të paktën 14 ditësh në: 12.5 mg karvedilol në mëngjes dhe 12.5 mg karvedilol në darkë, deri në 25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë.
Doza maksimale	Minimumi pas 14 ditësh: 25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë.

Në fillim të trajtimit, edhe për të moshuarit rekomandohen 12.5 mg karvedilol në ditë. Tek disa pacientë, ky dozim mund të sigurojë ulje të mjaftueshme të presionit të gjakut edhe në terapinë afatgjatë.

Në angina pectoris kronike të stabilizuar

Doza maksimale	Në trajtimin afatgjatë 25 mg karvedilol në mëngjes dhe 25 mg karvedilol në darkë.
----------------	---

Tek të moshuarit, nuk duhet të tejkalohet doza prej 2 x 25 mg karvedilol, e ndarë gjatë ditës.

Në rast se ndërpritni marrjen e karvedilolit për më shumë se dy javë, terapia duhet të riniset sërisht nga doza fillestare e më pas mund të rritet gradualisht sipas rekomandimeve.

Në qoftë se keni marrë më shumë Dilapro

Në qoftë se keni marrë më shumë Dilapro se sasia që duhet të merrni, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren. Simptoma e mbidozimit mund të përfshijnë: ndjenjë ligështie si pasojë e presionit tepër të ulët të gjakut, rrahje të ngadalta të zemrës dhe në raste të veçanta serioze, mungesë të rrahjeve të zemrës. Mund të shfaqet gjithashtu: vështrësi në fyëmarrje, ngushtim i rrugëve të ajrit, pafuqi, të vjella, nivel i ulët i vetëdijes dhe kriza konvulsive.

Në qoftë se harroni të merrni Dilapro

Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.

Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Dilapro

Doza e këtij bari nuk duhet të ndryshohet pa udhëzimin e mjekut. Po ashtu, trajtimi nuk duhet të ndërpritet pa udhëzimin e mjekut. Trajtimi me Dilapro nuk duhet ndërprerë në mënyrë të menjëhershme, por duhet të reduktohet gradualisht. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFekte anësore të mundshme

Si të gjitha barnat e tjera, karvediloli mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Shpeshtësia e efekteve të mundshme anësore tregohet në tabelën më poshtë:

Shumë të zakonshme:	Ndodhin në më shumë se 1 në 10 përdorues
Të zakonshme:	Ndodhin në 1 deri 10 përdorues nga 100
Të pazakonta:	Ndodhin në 1 deri 10 përdorues nga 1.000
Të rralla:	Ndodhin në 1 deri 10 përdorues nga 10.000
Shumë të rralla:	Ndodhin në më pak se 1 në 10.000 përdorues
Të panjohura:	Shpeshtësia nuk mund të përcaktohet nga të dhënat që disponohen.

Në tabelën më poshtë janë përmbledhur efektet anësore të raportuara gjatë studimeve me karvedilol.

Sistemi trupor	Efekti anësor	Shpeshtësia
Infeksione dhe sëmundje parazitare	Bronkit	Të zakonshme
	Inflamacion i mushkërive	Të zakonshme
	Infekcion i rrugëve të sipërme të frymëmarjes	Të zakonshme
Çrregullime të gjakut dhe sistemit limfatik	Infekcion i rrugëve urinare	Të zakonshme
	Anemi	Të zakonshme
	Ulje e numrit të pllakëzave të gjakut	Të rralla
Çrregullime të sistemit imunitar	Ulje e numrit të rruzave të bardha të gjakut	Shumë të rralla
	Mbindjeshmëri (reaksione alergjike)	Shumë të rralla
Çrregullime të metabolizmit dhe të ushqyerjes	Shtim në peshë	Të zakonshme
	Rritje e vlerës së kolesterolit	Të zakonshme
	Përkeqësim i mekanizmave që rregullojnë sheqerin në gjak (vlera të rritura të sheqerit në gjak, vlëra shumë të ulëta të sheqerit në gjak) tek pacientët me diabet melitus	Të zakonshme
Çrregullime psikiatrike	Depresion, gjendje depresive	Të zakonshme
	Çrregullime të gjumit	Të pazakonta
	Makthe	Të pazakonta
Çrregullime të zemrës	Haluçinacione	Të pazakonta
	Konfuzion	Të pazakonta
	Psikoza	Shumë të rralla
Çrregullime të sistemit nervor	Marrje mendësh	Shumë të zakonshme
	Dhimbje koke	Shumë të zakonshme
	Humbje afatshkurtrë e vetëdijes (sinkop [përfshirë presinkop])	Të zakonshme
Çrregullime të syve	Parestezi	Të pazakonta
	Çrregullime të shikimit	Të zakonshme
	Pakësim i lotëve (sy i thatë)	Të zakonshme
Çrregullime të zemrës	Irritim i syve	Të zakonshme
	Pamjaftueshmëri e funksionit të zemrës	Shumë të zakonshme
	Bradikardi (rrahje të ngadalta)	Të zakonshme
Çrregullime të zemrës	Sasi e shtuar e gjakut në qarkullim (hipervolemia)	Të zakonshme
	Eliminim jo i përshatshëm i lëngjeve	Të zakonshme
	Bllok AV	Të pazakonta
Çrregullime të zemrës	Atak i angina pectoris	Të pazakonta

Çrregullime të enëve të gjakut	Presion i ulët i gjakut	Shumë të zakonshme
	Hipotension ortostatik, çrregullime të qarkullimit periferik (gjymtyrë të flohta), sëmundje okluzive periferike, përkeqësım i simptomave tek pacientët me <i>Claudicatio intermittens</i> , dhimbje vaskulare tek gishtat e dorës ose të këmbës (sëmundja Raynaud)	Të zakonshme
	Presion i rritur i gjakut	Të zakonshme
Çrregullime të rrugëve të frymëmarjes, toraksit dhe mediastinit	Marrje fryme	Të zakonshme
	Grumbullim uji në mushkëri (edemë pulmonare)	Të zakonshme
	Astmë dhe marrje fryme tek pacientët me tendencë për ngushtim të rrugëve të frymëmarjes	Të zakonshme
Çrregullime të traktit gastrointestinal	Bllokim i hundëve	Të rralla
	Të përziera	Të zakonshme
	Diarre	Të zakonshme
	Të vjella	Të zakonshme
	Vështrësi në tretje	Të zakonshme
	Dhimbje barku	Të zakonshme
Çrregullime të mëlcisë dhe tëmthit	Kapsllëk	Të pazakonta
	Tharje goje	Të rralla
	Rritje e transaminazave në serum	Shumë të rralla
Çrregullime të lëkurës dhe indit të nënlëkurës	Reaksione në lëkurë, si ekzantemë alergjike, dermatit, urtikarie, kruarje, psoriazë, rash i ngjashëm me psoriazën	Të pazakonta
	Reaksione të rënda në lëkurë (p.sh. eritema multiforme, sindromi Stevens – Xhonsn, nekrolizë epidermale toksike)	Të panjohura
	Rënie flokësh	Të panjohura
Çrregullime muskuloskeletike dhe të indit lidhor	Dhimbje trupi	Të zakonshme
Çrregullime të veshkave dhe të rrugëve urinare	Pamjaftueshmëri e funksionit të veshkave, ose çrregullim i tyre tek pacientët me sëmundje vaskulare të gjenralizuar dhe / ose funksion të reduktuar të veshkave	Të zakonshme
	Çrregullime të urinimit	Të zakonshme
	Urinim i pavullnetshëm tek femrat	Shumë të rralla
	Impotencë	Të pazakonta
Çrregullime të riprodhimit dhe të gjirit	Asteni	Shumë të zakonshme
	Dhimbje	Të zakonshme
	Edema	Të zakonshme

Përshkrim i disa efekteve anësore

Marramendja, sinkopi, dhimbja e kokës dhe astenia përgjithësisht janë të lehta dhe më së shumti ndodhin në fillim të trajtimit. Tek pacientët me insuficiencë kardiakë kongjestive, mund të ndodhë përkeqësım i saj dhe i mbajtjes së lëngjeve, në fazën e rregullimit të dozës së karvedilolit.

Tek pacientët me insuficiencë kardiakë kronike me presion të ulët të gjakut, kardiopati iskemike dhe sëmundje vaskulare të përhapur dhe / ose pamjaftueshmëri ekzistuese të funksionit të veshkave, është vënë re një përkeqësım i rikthyeshëm i funksionit të veshkave gjatë terapisë me karvedilol.

Klasa e beta-blokuesve mund të shkaktojë shfaqjen e diabetit latent, përkeqësimin e diabetit ekzistues dhe përkeqësimin e mekanizmit të rregullimit të nivelit të sheqerit në gjak.

Karvediloli mund të shkaktojë inkontinencë urinare tek femrat, që zgjidhet me ndërprerjen e trajtimit.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI DILAPRO?

Mbajeni larg fëmijëve.

Mos e përdorni Dilapro pas datës së skadimit e cila është e shënuar në paketim. Mos e ruani mbi 25°C.

Ruajeni në paketimin original për ta mbrojtur nga drita dhe në një vend të thatë.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmbajnë tabletat Dilapro12.5 mg

Lënda aktive është karvedilol.

Çdo tabletë përmban 12.5 mg karvedilol.

Lëndët ndihmëse janë: celulozë mikrokristalore e silicifikuar, stearat magnezi.

Çfarë përmbajnë tabletat Dilapro 25 mg

Lënda aktive është karvedilol.

Çdo tabletë përmban 25 mg karvedilol.

Lëndët ndihmëse janë: celulozë mikrokristalore e silicifikuar, stearat magnezi.

Përmbajtja e paketimit

Dilapro 12.5 mg: Kuti me 30 table